- (b) The directors may refuse to register the transfer of a share, and, if they do so, the instrument of transfer must be returned to the transferee together with a notice of refusal giving reasons for such refusal as soon as practicable and in any event within two months after the date on which the instrument of transfer was lodged for registration, unless the directors suspect that the proposed transfer may be fraudulent.

**LIGJI PËR SHOQËRITË TREGTARE 2006**  
**PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**STATUTI I**  
**A K WELL SERVICES LIMITED**

**1. HYRJE**

- 1.1. Nenet model të statutit për shoqëritë private me përgjegjësi të kufizuar të përfshira në Skedën 1 (Nenet Model) të Rregulloreve të Shoqërive 2008 (SI 2008 Nr. 3229) ("Nenet Model") do të aplikohen ndaj Shoqërisë për aq kohë sa zbatohen ose amendohen në këtë mënyrë dhe keto Nene Model dhe nenet e mëposhtme do të shërbejnë si Statut I Shoqërisë (Statuti).
- 1.2. Cdo reference ndaj Ligjit për Shoqëritë Tregtare 2006 do të përfshije një reference ndaj amendimit ose rimirimit të dispozitave në fuqi.
- 1.3. Nenet Model 7(2), 9(2), 14, 19(5), 21, 24, 26(5), 28(3), 36(4) dhe 44(4) nuk aplikohen ndaj Shoqërisë.
- 1.4. Titujt e këtij Statuti janë hartuar për lehtësi dhe do të injorohen gjatë interpretimit të gjuhës dhe kuptimit të Neneve.
- 1.5. Në këto Nene, përveç se kur përcaktohet ndryshe nga konteksti, cdo referencë ndaj emrave në shumës do të konsiderohet e vlefshme edhe për njëjës dhe anasjelltas, referencat ndaj gjinive përfshijnë të gjitha gjinitë dhe referencat ndaj personave përfshijnë trupa korporatash ose shoqata të pajegjistruara.

**2. TERMAT E PERDORUR**

- 2.1. Neni Model 1 do të ndryshojë me përfshirjen e përcaktimeve të mëposhtme:

"emëruesi" ka kuptimin e dhënë nga Neni 7.1;

"kërkesë" ka kuptimin e dhënë nga Neni 10.1;

"njoftim për kërkesë" ka kuptimin e dhënë nga Neni 10.1;

"data e pagesës së kërkesës" ka kuptimin e dhënë nga Neni 10.4;

"konfiskim" ka kuptimin e dhënë nga Neni 10.4;

"njoftim për zbatim pengue" ka kuptimin e dhënë nga Neni 9.4;

"tarifë e duhur" ka kuptimin e dhënë nga Neni 10.4;

"sekretar" i referohet sekretarit të shoqërisë, nese ka, emëruar sipas nenit 6.1 ose cdo person tjetër i emëruar për të kryer detyrat e sekretarit të shoqërisë, përfshirë zëvendësuesin, asistentin ose sekretarin e përbashkët; dhe

"dite pune" i referohet nje dite që nuk është e Shtune ose e Djelë, Dite Krishtlindjesh, e Premtja para Pashkëve ose cdo ditë tjetër që është pushim zyrtar sipas Ligjit të Bankës dhe Financiar 1971 në atë pjesë të Mbretërisë së Bashkuar ku është regjistruar Shoqëria.

### **3. Procedura e Drejtorëve**

Numri maksimal dhe minimal i drejtorëve mund të përcaktohet në kohë të ndryshme me anë të vendimeve të asamblesë së zakonshme. Duke qenë subjekt i këtyre vendimeve ose në mungesë të tyre, nuk do të ketë numër maksimal drejtorësh dhe numri minimal i drejtorëve do të jetë një. Në rastet kur numri minimal i drejtorëve është një, nuk aplikohet rregulli i përgjithshëm i vendimarrjes së drejtorëve dhe drejtori i vetëm mund të marrë vendime pa u kushtëzuar nga parashikimet e Statutit (përfshirë Nenin model 11 (2)) në lidhje me vendimarrjen e drejtorëve.

Sipas Nenit 3.3, megjithëse një vendim i propozuar nga drejtorët ka ose mund të ketë lidhje me ndonjë çështje, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me ndonjë lloj interesi, drejtori mund të marrë pjesë në vendimarrje si për qëllime asambleje ashtu edhe votimi.

Nëse drejtorët propozojnë ushtrimin e kompetencave të tyre sipas kapitullit 175(4)(b) të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 2006 për të autorizuar një konflikt interesi të ndonjë drejtori, drejtori që përballet me konfliktin nuk merr pjesë në asamble dhe votim për vendimin që autorizon konfliktin.

Sipas parashikimeve të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 2006 dhe në rast se (nëse ky ligj e kërkon) drejtori ka deklaruar para drejtorëve natyrën dhe permasa e cdo interesi të tij të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pavarësisht detyrës:

- a) Mund të jetë pjesë ose i interesuar në cdo transaksion ose angazhim me Shoqërinë ose në të cilin Shoqëria është e interesuar;
- b) Mund të jetë drejtor ose mbajë ndonjë post tjetër ose punonjës, ose pjesë në cdo transaksion ose angazhim, ose i interesuar në cdo degë të shoqërisë ose trup korporate në të cilën Shoqëria është e interesuar; dhe
- c) Nuk është i përgjegjshëm ndaj Shoqërisë për cdo shpërblim ose benfitet të tjera që rrjedhin nga ky post ose punësim ose nga ky transaksion ose angazhim ose interes në cdo trup korporate të tillë dhe asnjë transaksion ose angazhim nuk mund të shmanget në kuadër të cdo shpërblimi ose benefiti ose interesi të tillë.

### **4. Vendimet Unanime**

Neni Model 8(2) do të amendohet nga fshirja e fjalëve "kopjet e të cilave janë nënshkruar nga cdo drejtor i zgjedhur" dhe zëvendësimi i tyre me sa vijon "ku cdo drejtor i zgjedhur ka nënshkruar një ose më shumë kopje të saj". Neni 8 (2) do të lexohet në përputhje.

### **5. Përfundimi i mandatit të drejtorit**

5.1 Përveç rasteve të parashikuara në Nenin Model 18 për përfundimin e mandatit të drejtorit, një person bie nga detyra e drejtorit nëse ka munguar në mbledhjet e bordit të drejtorëve për më shumë se gjashtë muaj rresht pa lejen e tyre dhe drejtorët vendosin t'a lirojnë nga detyra.

### **6. Sekretari**

Drejtorët mund të caktojnë një sekretar të Shoqërisë për një periudhë të caktuar, me një shpërblim të caktuar dhe në kushte të caktuara sipas nevojave të rastit; dhe cdo sekretar i caktuar nga drejtorët mund të hiqet prej tyre.

### **7. Drejtorët zëvendësues**

7.1

- a) Cdo drejtor (emëruesi) mund të emërojë si zëvendësues cdo drejtor tjetër, ose cdo person të miratuar me vendim drejtorësh, për:
  - i. të ushtruar kompetencat e drejtorit; dhe
  - ii. përmbushur përgjegjësitë e drejtorit,

Në lidhje me vendimarrjen e drejtorëve në mungesë të drejtorit emërues.

- b) Cdo emërim ose shkarkim i një zëvendësuesi duhet njoftuar me shkrim në Shoqëri dhe duhet firmosur nga emëruesi, ose me cdo mjet tjetër të miratuar nga drejtorët. Njoftimi duhet:
  - i. të identifikojë zëvendësuesin e propozuar; dhe
  - ii. në rast njoftimi për emërim, të përmbajë një deklaratë të firmosur nga zëvendësuesi që dëshmon vullnetin e tij për të vepruar si zëvendësues për emëruesin e tij.

## 7.2

- a) Një drejtor zëvendësues gëzon të njëjtat të drejta për të marrë pjesë në mbledhjen e drejtorëve ose vendimarrje në përputhje me Nenin Model 8, si zëvendësues i emëruesit.
- b) Përveç rasteve kur Statuti e përcakton ndryshe, drejtorët zëvendësues:
  - i. konsiderohen drejtorë për të gjitha qëllimet;
  - ii. janë përgjegjës për aktet dhe veprimet e tyre;
  - iii. janë subjekt i të njëjtave kufizime si emëruesit e tyre;
  - iv. nuk kanë përgjegjësi si agjentë të emëruesve të tyre.
- c) Një person që është drejtor zëvendësues por jo drejtor:
  - i. mund të merret në konsideratë si pjesëmarrës në asamble (vetëm në rastin kur emëruesi i tij nuk është pjesëmarrës); dhe
  - ii. mund të firmosë osë tregojë marrëveshjen e tij me shkrim në një vendim të shkruar sipas Nenit 8 (por vetëm nëse emëruesi i tij nuk ka firmosur ose treguar marrëveshjen e tij ndaj këtij vendimi me shkrim).

Asnjë zëvendësues nuk llogaritet më shumë se një drejtor për këto qëllime.

- d) Një drejtor zëvendësues nuk ka të drejtë të marrë shpërblim nga Shoqëria për zëvendësimin e një drejtori përveç pjesës së paguar të këtij shpërblimi ndaj emëruesit nëse emëruesi përcakton kështu me njoftim me shkrim ndaj Shoqërisë.
- e) Neni Model 20 amendohet duke fshirë cdo reference ndaj "drejtorëve" dhe zëvendësohet me "drejtorët dhe/ose cdo drejtor zëvendësues".

## 7.3

Emërimi si drejtor zëvendësues përfundon:

- a) kur revokohet nga drejtori emërues me njoftim të shkruar në Shoqëri ku specifikohet koha e përfundimit;
- b) në rastin e cdo ngjarjeje që do të rezultonte me përfundimin e mandatit të emëruesit si drejtor;
- c) me vdekjen e emëruesit;
- d) kur mandati i emëruesit të tij përfundon.

## 8. Emetimi i kuotave

8.1 Kuotat mund të jepen si aspak, pjesërisht ose tërësisht të shlyera.

## 8.2

- a) Përvec rasteve kur ortakët e Shoqërisë vendosin ndryshe me vendim të posacëm, të gjitha kuotat e propozuara nga drejtorët u duhen ofruar fillimisht ortakëve në përputhje me parashikimet e mëposhtme të këtij neni.
- b) Kuotat u duhen ofruar ortakëve në proporcion sa më shumë të jetë e mundur me numrin e kuotave të tyre respektive në zotërim.
- c) Oferta duhet të bëhet me shkrim duke përcaktuar numrin kuotave të ofruara dhe një afat (jo më pak se 14 dite) në përfundim të të cilit oferta, nëse nuk pranohet, do të konsiderohet e refuzuar.
- d) Pas përfundimit të afatit të cituar në pikën (c) më sipër, kuotat e refuzuara do t'u ofrohen personave që, brenda afatit të cituar, kanë pranuar të gjitha kuotat e ofruara; dhe kjo ofertë e mëtejshme do të kryhet në të njëjta kushte dhe mënyra dhe kufizime si oferta fillestare.
- e) Cdo kuotë që nuk është pranuar nga oferta sipas pikës (c) dhe oferta e mëtejshme sipas pikës (d) ose që nuk mund të ofrohet sic u përshkrua më sipër përvec se me ndarje dhe cdo kuotë e leshuar sipas parashikimeve të këtij neni me cdo vendim të posacëm do të jetë nën kontrollin e drejtorëve, të cilët mund të caktojnë, garantojnë opsione ose vënë në dispozicion ndaj këtyre personave, me këto kushte dhe mënyra që shkojnë për shtat sipas tyre.

8.3 Në përputhje me kapitullin 567 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 2006, kapitujt 561 dhe 562 të këtij Akti përjashtohen.

## 9. Pengu

9.1 Shoqëria ka të drejtën e parë dhe supreme të pengut mbi kuotat (qofshin plotësisht të shlyera apo jo) e regjistruara në emër të cdo debitori ndaj Shoqërisë, qoftë i regjistruar si zotërues individual i kuotave qoftë në bashkëzotërim me ortakë të tjerë, për të gjitha paratë që pronësia e tij ka si detyrim ndaj Shoqërisë (qofshin këto para të shlyera ose jo në të tashmen).

9.2 Pengu i Shoqërisë mbi kuotat:-

- a) ka prioritet mbi cdo palë të tretë të interesuar; dhe
- b) shtrihet mbi të gjitha dividendet ose paratë e pagueshme nga Shoqëria në lidhje me këto kuota dhe (nëse pengu i Shoqërisë zbatohet dhe këto kuota shiten prej saj) fitimet që rrjedhin prej tyre.

9.3 Drejtorët në cdo kohë mund të vendosin se cili mund të jetë apo mos jete subjekt i pengut të Shoqërisë, pjesërisht ose tërësisht.

## 9.4

- a) Subjekt i parashikimeve të këtij neni, nëse:-
  - i. Shoqëria ka dërguar një njoftim rreth qëllimit të zbatimit të pengut ("njoftim për zbatim pengu") sipas kuotave; dhe
  - ii. personi të cilit i dërgohet njoftimi për zbatim pengu nuk e ka përmbushur atë, Shoqëria mund t'i shesë kuotat sipas vendimin të Bordit.
- b) Një njoftim për zbatim pengu:-
  - i. mund të dërgohet vetëm nëse shuma e kuotave është e shlyeshme ndaj Shoqërisë nga ortaku i vetëm i regjistruar ose dy ose më shumë ortakë në bashkëzotërim të kuotave dhe data e shlyerjes ka kaluar;
  - ii. duhet të përcaktoje kuotat për të cilat bëhet fjale;
  - iii. duhet të përshijë kërkesën për shumën e pagueshme Brenda 14 ditësh;
  - iv. duhet t'i dërgohet ose mbajtësit të këtyre kuotave ose personit të autorizuar për këto kuota si pasojë e vdekjes së ortakut, falimentimit ose të tjera; dhe
  - v. duhet të theksojë qëllimin e Shoqërisë për të shitur këto kuota nëse njoftimi nuk përmbushet.
- c) nëse kuotat shiten sipas dispozitave të këtij Neni:-

- i. drejtorët mund të autorizojnë cdo person për të ekzekutuar një transferte kuotash ose blerje ose një person të emëruar nga blerësi;
  - ii. marrësi nuk është i detyruar të shqyrtojë aplikimin e konsideratës, dhe titulli i tij nuk preket nga asnjë parregullsi ose pavlefshmëri e procesit të shitjes.
- d) Fitimi neto si rezultat i shitjes (pas pageses së shpenzimeve të shitjes dhe cdo shpenzimi tjetër për zbatimin e pengut) duhet aplikuar:-
- i. fillimisht, gjatë pagesës së shumës për të cilën ekziston pengu sic rezulton e pagueshme në datën e zbatimit të pengut; dhe
  - ii. së dyti, gjatë pagesës së personit zotëues të kuotës në datën e shitjes, por vetëm pasi certifikata e kuotave të shitura është dorëzuar në Shoqëri për c'regjistrim ose në rast humbje të kësaj certifikate pasi është dhënë një dëmshpërblim i përshtatshëm, dhe është objekt i pengut të barazvlefshëm me pengun e shoqërisë mbi kuotat para shitjes për të gjitha detyrimet e pagueshme në lidhje me kuotat pas datës së zbatimit të pengut.
- e) Deklarata e Drejtorit ose Sekretarit sipas Statutit që është Drejtor ose Sekretar dhe që kuota është shitur për të përmbushur pengun e Shoqërisë në një datë të caktuar:-
- i. është provë për faktet e specifikuar në të kundër pretendimeve të personit mbi kuotën; dhe
  - ii. është subjekt i pajtueshmërisë me cdo formalitet ose transfertë të kërkuar nga ligji ose ky Statut, që përbën një titull të mirë për kuotën.

## 10. Kërkesa për të paguar kuotat dhe anulimi i tyre

### 10.1

- a) Sipas Statutit dhe kushteve të caktimit të kuotave, drejtorët mund të dergojnë një kërkesë ndaj një ortaku për t'i kërkuar pagesën e një shume parash (kërkesa) e cila paguhet sipas kuotave që ortaku zoteron në datën kur drejtorët vendosin të dergojnë kërkesën.
- b) Njoftimi i kërkesës:
- i. mund të mos i kërkojë një ortaku të paguajë kur kërkesa tejkalon totalin e shumës së papaguar të kuotave të atij ortaku (ose vlerën nominale të kuotës ose cdo shumë të pagueshme ndaj Shoqërisë me ane të primit).
  - ii. duhet të përcaktojë kur dhe si duhet paguar cdo kërkesë e lidhur me të; dhe
  - iii. mund të lejojë ose kërkojë që pagesa të kryhet me këste.
- c) Ortaku duhet të përmbushë kriteret e njoftimit të kërkesës, por asnjë ortak nuk është i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë përpara afatit 14 ditor që nga dërgimi i kërkesës.
- d) Përpara se shoqëria të marrë pagesën e cdo kërkesë falë njoftimit të kërkesës drejtorët mund:
- i. ta revokojnë atë pjesërisht ose tërësisht; ose
  - ii. të caktojnë një afat të mëvonshëm nga afati i përcaktuar në njoftim.

### 10.2

- a) Përgjegjësia për të paguar një kërkesë nuk shlyhet ose transferohet nëpërmjet transferimit të kuotave për të cilat është bërë kërkesa për pagesë.
- b) Zotëuesit e përbashkët të kuotave janë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht për shlyerjen e pagesës së kërkesës sipas njoftimit.
- c) Në përputhje me kushtet sipas të cilave caktohen kuotat, drejtorët mund të lidhin marrëveshje për emetimin e kuotave midis zotëuesve për një diferencë në shumat dhe kohën e pagesës së kërkesave mbi kuotat e tyre.

### 10.3

- a) Një njoftim për kërkesë mund të mos lëshohet me shumat e përcaktuara, sipas kushteve të caktimit të kuotave, si të pagueshme ndaj Shoqërisë në lidhje me atë kuote (qoftë në lidhje me vlerën nominale ose prim):
  - i. me caktim;
  - ii. me ndodhjen e një ngjarjeje të vecantë; ose
  - iii. në një datë të përcaktuar sipas kushteve të emetimit.
- b) Nëse data e pagesës së kësaj shume ka kaluar dhe pagesa nuk është shlyer, zotëruesi i kuotës në fjalë ka dështuar në përmbushjen e detyrimit të njoftimit në lidhje me shumën dhe konsiderohet përgjegjës për pagesën e interesit dhe kamatvonesës.

### 10.4

- a) Nëse një person ka për detyrim të paguajë një kërkesë dhe nuk e shlyen detyrimin brenda datës së njoftuar:
  - i. drejtorët mund t'i dërgojnë një njoftim konfiskimi; dhe
  - ii. deri në shlyerjen e pagesës, personi detyrohet të paguajë ndaj Shoqërisë interesat e kërkesës nga data e njoftimit sipas tarifës së duhur.
- b) Për qëllim të këtij Neni:
  - i. "data e pagesës së kërkesës" është data në të cilën njoftimi përcakton pagesën e kërkesës, përvec rastit kur drejtorët njoftojnë një datë të mëvonshme, rast në të cilin data e pagesës së kërkesës është data e mëvonshme; dhe
  - ii. "tarifa e duhur" është tarifa e përcaktuar nga kushtet sipas të cilave janë shpërndarë kuotat ose, nëse nuk është përcaktuar një tarifë e tillë gjatë shpërndarjes së kuotave, pesë për qind në vit.
- c) Tarifa e duhur nuk duhet të tejkalojë me më tepër se pesë për qind tarifën bazë të huasë të përcaktuar më së fundmi nga Politika Monetare e Komitetit të Bankës së Anglisë në lidhje me përgjegjësitë e saj sipas Pjesës II të Ligjit për Bankën e Anglisë 1998.
- d) Drejtorët mund të heqin dorë nga cdo detyrim për të paguar pjesërisht ose plotësisht një kërkesë.

### 10.5 Njoftimi për konfiskim

- a) mund të dërgohet në lidhje me cdo kuotë për të cilën kërkesa për pagesë nuk është shlyer sipas njoftimit;
- b) i duhet dërguar zotëruesit të kuotës ose personit që e gëzon të drejtën e kuotës për shkak të vdekjes së zotëruesit, falimentimin ose tjetër;
- c) duhet të kërkojë pagesën e një kërkesë ose cdo interesi të llogaritur me datë jo më pak se 14 dite pas datës së njoftimit për konfiskim;
- d) duhet të përcaktojë mënyrat e shlyerjes së pagesës;
- e) duhet të theksojë se në rast mospërmbushje të njoftimit për konfiskim, kuotat për të cilat është dërguar njoftimi për pagesë do të konfiskohen.

10.6 Nëse një njoftim për konfiskim nuk përmbushet përpara datës brenda së cilës kërkohet pagesa e njoftuar në kërkesën për konfiskim, drejtorët mund të vendosin që cdo kuotë në lidhje me të cilën u njoftua kërkesa të konfiskohet dhe konfiskimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose paratë e pagueshme në lidhje me kuotat e konfiskuara dhe të papaguara përpara konfiskimit.

## 10.7

- a) Sipas parashikimeve të këtij Neni, konfiskimi i nje kuote shuan:
  - i. të gjitha interesat e kuotës, pretendimet dhe kërkesat ndaj Shoqërisë në lidhje me të; dhe
  - ii. të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera të lidhura me kuotën si mes personit titullar të kuotës dhe Shoqërisë.
- b) Cdo kuotë e konfiskuar:-
  - i. do të konfiskohet pasi bordi i drejtorëve të vendosë kështu;
  - ii. është në pronësi të Shoqërisë; dhe
  - iii. mund të shitet, rishpërndahet ose përcaktohet ndryshe si të konsiderohet e përshtashme nga drejtorët.
- c) Nëse kuotat e një personi janë konfiskuar:-
  - i. Shoqëria duhet t'i dërgojë këtij personi njoftimin që kuotat janë konfiskuar dhe ta regjistrojë këtë veprim në regjistrin e ortakëve;
  - ii. ky person pushon së qeni ortak për ato kuota;
  - iii. ky person duhet të dorëzojë certifikatën e kuotave të konfiskuara për c' regjistrim;
  - iv. ky person vazhdon të jetë debitor ndaj Shoqërisë për të gjitha shumat për t'u shlyer nga ky person në datën e konfiskimit në lidhje me këto kuota, duke përfshirë cdo interes (të llogaritur përpara ose pas dates së konfiskimit); dhe
  - v. drejtorët mund të heqin dorë nga pagesa e këtyre shumave tërësisht ose pjesërisht ose të detyrojnë pagesën pa asnjë lëshim për vlerën e kuotave në kohën e konfiskimit ose për cdo konsideratë të marrë në dispozicion të tyre.
- d) Në cdo kohë përpara se Shoqëria të vendosë konfiskimin e kuotave, drejtorët mund të vendosin të anullojnë konfiskimin sipas kusheve të vendosura prej tyre.

## 10.8

- a) Nëse një kuotë e konfiskuar është predispozuar për t'u transferuar, Shoqëria mund të marrë në konsideratë transferimin dhe drejtorët mund të autoizojnë cdo person për ekzekutimin e mjetit të transfertës.
- b) Një deklaratë sipas statutit e drejtorit ose sekretarit që deklaruesi është drejtor ose sekretar dhe që kuota është konfiskuar në një datë të caktuar:-
  - i. është prove përfundimtare e faktit të përcaktuar në të kundër cdo personi që pretendon së ka të drejta mbi kuotën, dhe
  - ii. subjekt i pajtueshmërisë me cdo formalitet tjetër të transferimit të kërkuar nga ky Statut ose ligji, përben një titull të mirë për kuotën.
- c) një person ndaj të cilit transferohet një kuotë e konfiskuar nuk është i detyruar të shohë aplikimin e konsiderimit (nëse ka) dhe e drejta e tij mbi kuotën nuk është e prekur nga ndonjë parregullsi ose pavleshmëri që mund të cojë në konfiskim ose transferim të kuotës.
- d) Nëse shoqëria shet një kuotë të konfiskuar, personi që e zotëronte përpara konfiskimit ka të drejtë të marrë nga Shoqëria fitimin e shitjes, neto pa komisione, me përjashtim të shumave të cilat:
  - i. ishin, do të bëheshin të pagueshem; dhe
  - ii. nuk ishin paguar nga personi zotërues i kuotës kur kuota u konfiskua, por në lidhje me këtë procedurë nuk paguhen interesa ndaj këtij personi dhe Shoqëria nuk duhet të japë llogari për paratë e fituara mbi të.

## 10.9

- a) Një ortak mund të dorëzojë cdo kuotë:-
  - i. në lidhje me të cilën drejtorët mund të lëshojnë një njoftim konfiskimi;



- ii. të cilën drejtorët mund ta konfiskojnë;
- iii. e cila është konfiskuar.
- b) Drejtorët mund të pranojnë dorëzimin e cdo kuote të tillë.
- c) Pasojat e dorëzimit mbi kuotën janë njësoj si pasojat e konfiskimit mbi kuotën;
- d) Një kuotë e dorëzuar mund të trajtohet njësoj si një kuotë e konfiskuar.

## 11. Certifikatat e kuotave

### 11.1

- a) Shoqëria duhet të lëshojë për cdo ortak një ose më shumë certifikata në përputhje me kuotat që zotërojnë.
- b) Përvec rasteve kur parashikohet ndryshe nga Statuti, të gjitha certifikatat duhet të jepen falas.
- c) Nuk mund të jepen certifikatë për kuota që i përkasin më shumë se një tipi.
- d) Një ortak mund t'i kërkojë Shoqërisë me shkrim, të zëvendësojë:-
  - i. certifikatat e ndara të ortakut me një të konsoliduar; ose
  - ii. certifikatën e konsoliduar me dy ose më shumë certifikata të ndara.
- e) Kur shoqëria merr kërkesën e një ortaku sipas pikës (d) më sipër, mund të përcaktojë një tarifë të arsyeshme me vendim të drejtorëve.

### 11.2

- a) Cdo certifikatë duhet të përcaktojë:-
  - i. për sa kuota, të cilit lloj, lëshohet;
  - ii. vlerën nominale të këtyre kuotave;
  - iii. nëse kuotat janë zero, shlyer tërësisht apo pjesërisht; dhe
  - iv. cdo numër dallues të caktuar ndaj tyre.
- b) Certifikatat duhet:-
  - i. të përmbajnë vulën e Shoqërisë; ose
  - ii. të lëshohen përndryshe në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

## 12. Konsolidimi i kuotave

### 12.1

- a) Ky nen aplikohet në rrethana kur:-
  - i. ka ndodhur një konsolidim i kuotave; dhe
  - ii. si rezultat, ortakët janë mbajtës të fraksioneve të kuotave.
- b) Drejtorët mund:-
  - i. të shesin kuotat që përfaqësojnë fraksionet ndaj cdo personi përfshirë Shoqërinë për cmimin më të arsyeshëm; dhe
  - ii. të autorizojnë cdo person të ekzekutojë një mjet transferimi të kuotave ndaj blerësit ose një personi të emëruar nga blerësi.
- c) Nëse e drejta e cdo titullari mbi një pjesë të të ardhurave nga shitja është më e vogël se minimumi i përcaktuar nga drejtorët, pjesa e këtij ortaku mund të shpërndahet për bamirësi sipas ligjeve të Anglisë dhe Wellsit, Skocisë ose Irlandës së Veriut.

- d) Personi ndaj të cilit transferohen kuotat nuk është i detyruar të sigurohet që paratë nga blerja t'i dërgohen personit që gezon të drejtat mbi fraksionin përkatës.
- e) E drejta e te Transferuarit mbi kuotat nuk preket nga ndonjë parregullsi ose pavlefshmëri e procesit që coi në shitjen e tyre.

### 13. Dividendet

#### 13.1

- a) Përvec rasteve kur parashikohet ndryshe nga Statuti ose të drejtat mbi kuotat, të gjithë dividendet duhet të jenë:-
  - i. të deklaruar dhe paguar sipas shumave të paguara mbi kuotat mbi te cilat paguhet dividendi; dhe
  - ii. të ndarë dhe paguar në proporcion me shumat e paguara mbi kuotat gjatë cdo ndarje ose ndarjes së periudhes në të cilën është paguar dividendi.
- b) nese kuota emetohet sipas kushteve që e rendisin për dividend ndaj një date të caktuar, kuota renditet për dividend në përputhje me të.
- c) për të llogaritur dividendet, nuk merret ne llogari asnje shumë që është paguar paraprakisht mbi kuotën përpara datës se përfundimit të afatit për shlyerjen e pagesës.

### 14. Kapitalizimi i fatimit

#### 14.1 Nje shume e kapitalizuar përvetësuar nga fitimi ne gjendje për t'u shpërndarë mund të aplikohet:-

- a) në ose ndaj shlyerjes së shumës së pashlyer ose cdo zero ekzistues ose kuotave pjesërisht të paguara nga personi mbajtës; ose
- b) në pagesën e detyrimeve të reja të Shoqërisë që më pas shpërndahen si plotësisht të paguara ndaj personave titullarë ose sipas rastiit.

14.2 Neni 36(5)(a) amendohet duke hequr fjalët "paragrafët (3) dhe (4)" dhe zëvendësohen me "Neni 36(5)(a) dhe Neni 14.1".

### 15. Vendimet e shkruara te Ortakëve

#### 15.1

- a) Sipas Nenit 15.1(b), një vendim ortakësh i shkruar në përputhje më Pjesën 13 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 2006 është i vlefshëm dhe në fuqi si vendim i marrë ne mbledhje të përgjithshme të Shoqërisë.
- b) Pikat qe vijojne nuk mund te kalojne si vendime te shkruara dhe mund te kalojnë vetëm me mbledhje te përgjithshme:-
  - i. nje vendim sipas kapitullit 168 të Ligjit për Shoqërite Tregtare 2006 për largimin e një drejtori përpara përfundimit të mandatit; dhe
  - ii. një vendim sipas kapitullut 510 të Ligjit për Shoqërite Tregtare 2006 për largimin e një audituesi përpara përfundimit të mandatit;

#### 15.2

- a) sipas Nenit 15.2 (b), me vendim të shkruar, cdo ortak ka një votë për cdo kuotë që zotëron.
- b) Asnje anetar nuk mund të votojë në vendim të shkruar përveç rastiti kur ka shlyer të gjitha pagesat në lidhje me te gjitha kuotat që zotëron.

## 16. Thirrje për Asamblene e Përgjithshme

### 16.1

- a) Cdo njoftim që thërret një mbledhje të përgjithshme të Shoqërisë duhet të përmbushë kriteret:
  - i. kapitulli 311 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare 2006 për përcaktimin e kohës, datës dhe vendit të takimit dhe natyrës së përgjithshme të aktivitetit për të cilin do diskutohet gjatë mbledhjes.
  - ii. kapitulli 325 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare 2006 për dhënien e informacionit ndaj ortakeve në lidhje me të drejtat e tyre për të lëshuar prokurë.
- b) cdo njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me cdo mbledhje të përgjithshme që cdo ortak ka të drejtë të marrë duhet dërguar cdo drejtori dhe audituesve (nese ka) të Shoqërisë.

## 17. Asambleja e Përgjithshme

### 17.1

- a) Nëse dhe për sa kohë Shoqëria ka vetëm një drejtor i cili ka të drejtën e votes në një asamble të përgjithshme, dhe ky ortak është i pranishëm në mbledhje personalisht ose përfaqësuar me prokurë nga një ose disa persona, në rastin kur anetari është një korporatë, nga një ose më shumë përfaqësues të korporatës, konsiderohet e mbledhur një asamble.
- b) Nëse dhe për sa kohë Shoqëria ka dy ose më shumë drejtorë të cilët kanë të drejtën e votes në një asamble të përgjithshme, këta dy ortakë të pranishëm në mbledhje personalisht ose përfaqësuar me prokurë nga një ose disa persona, në rastin kur anetari është një korporatë, nga një ose më shumë përfaqësues të korporatës, konsiderohet e mbledhur një asamble.
- c) Neni 41(1) amendohet me shtimin e një fjalie të dytë si vijon:-  
"Nëse, në mbledhjen e përgjithshme, asambleja nuk mblidhet brenda gjysëm ore nga orari i përcaktuar ose përndryshe nëse asambleja nuk mblidhet, mbledhja do të konsiderohet e shkrire".

## 18. Votimi në Asamblene e Përgjithshme

### 18.1

- a) Sipas nenit 18.2 më poshtë, mbi votën në asamblene e përgjithshme me ngritje dore:-
  - i. cdo ortak i cili si individ është i pranishëm personalisht, ka të drejtën e një vote;
  - ii. nëse një ortak (qoftë individ ose korporatë) cakton një ose më shumë përfaqësues për të qene në mbledhje, të gjithë përfaqësuesit e emëruar kanë të drejtën kolektive të vetëm një vote; dhe
  - iii. nëse një korporatë cakton një ose më shumë përfaqësues për të qene në mbledhje, të gjithë përfaqësuesit e emëruar kanë të drejtën kolektive të vetëm një vote sipas kapitullit 323(4) të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 2006.
- b) Sipas Nenit 18.2 më poshtë, cdo anetar (qoftë i pranishëm personalisht, me prokurë ose përfaqësues të autorizuar) në asamblene e përgjithshme gjatë votimit ka një votë në përputhje me cdo kuotë të zotëruar prej tij.

### 18.2

Asnjë ortak nuk mund të votojë në asamblene e përgjithshme ose cdo mbledhje të vecantë të mbajtesvë të cdo lloj kuote në Shoqëri, qoftë personalisht, me prokurë ose, në rastin kur anetari është një korporatë, nëpërmjet përfaqësuesit të korporatës sipas kuotave të zotëruara nëse nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e pagueshme në lidhje me cdo kuotë të zotëruar.

### 18.3

- a) Neni Model 44(2) amendohet duke fshire fjalen "ose" ne Nenin Model 44(2)(c), fshirjen e "." Pas fjalës "vendim" në Nenin Model 44(2)(d) dhe zevendësimin me "," ose " dhe vendosjen e nje Neni te ri 44(2)(e) ne termat e meposhtem:-  
"nga një ortak ose ortakë zoterues të kuotave që i japin të drejtë vote ne mbledhje duke qene kuota mbi të cilat eshte shlyer nje shume totale e barabate me jo më pak se një të dhjeten e shumës totale te shlyer mbi te gjitha kuotat qe japin kete te drejtë".
- b) kërkesa për votim qe behet nga nje person si përfaqësues i një anetari është njësoj më kërkesen që behet nga anetari.

18.4

Votimet duhen mbajtur ne asamblete e pergjithshme ku kerkohen dhe sipas mënyrave te percaktuara nga presidenti.

## 19. Dërgimi i njoftimeve prokurë

19.1 Neni Model 45(1) amendohet, termi "njoftim prokurë" (sic përcaktohet ne Nenin 45(1)) dhe cdo njehsim i tij i kërkuar nga drejtorët duhet derguar në një adresë të posacme të përcaktuar në njoftimin prokurë nga Shoqëria jo me pak se 48 orë përpara orarit të mbledhjes ose takimit të shtyrë në të cilin i emëruari sipas prokurës propozohet të votojë në përputhje me njoftimin prokurë; dhe cdo njoftim prokurë i mbërritur në atë adresë më pak se 48 orë përpara fillimit të mbledhjes ose takimit të shtyre nuk do të jetë i vlefshëm.

## 20. Komunikimet

20.1 Sipas parashikimeve të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 2006, një dokument ose informacion mund të dergohet nga Shoqëria ndaj një personi duke u publikuar në website.

20.2

- a) Ortaku adresa e të cilit ndodhet jashtë Mbretërisë së Bashkuar dhe I cili I komunikon Shoqërisë një adresë Brenda Mbretërisë së Bashkuar për dërgimin e njoftimeve ose një adresë elektronike për dërgimin e njoftimeve, ka të drejtë të marrë njoftime në këtë adresë, përndryshe nuk gëzon te drejtën e marrjes së njoftimeve nga Shoqëria.
- b) Për kuotat në zotërim të përbashkët, Shoqëria mund t'i dergojë njoftimet dhe të gjitha dokumentet në adresën e mbajtësit të kuotave emir I të cilit është regjistruar I pari në regjistrin e ortakëve dhe nuk është e detyruar të shpërndajë njoftimet ose dokumentat nëpër zotëruesit e tjerë të përbashkët.

20.3

- a) Nëse Shoqëria dërgon ose ofron njoftime ose dokumente të tjera me postë të klasit të parë dhe provon se këto dokumentë janë adresuar në mënyrë korrekte, janë paguar paraprakisht dhe dërguar me postë, marrësi i parashikuar duhet t'i marrë këto njoftime ose dokumente të tjera 48 orë pasi janë derguar ose mundësuar.
- b) Nëse Shoqëria dërgon ose ofron njoftime ose dokumente të tjera me postë elektronike dhe provon se këto dokumentë janë adresuar në mënyrë korrekte, marrësi i parashikuar duhet t'i marrë këto njoftime ose dokumente të tjera 24 orë pasi janë derguar ose mundësuar.
- c) Nëse Shoqëria dërgon ose ofron njoftime ose dokumente të tjera nëpërmjet faqes ëeb, marrësi I parashikuar duhet t'i marrë këto njoftime ose dokumente të tjera në momentin kur këto njoftime dhe dokumente shfaqen në faqen web, ose, nëse më vonë, në momentin kur marrësi i parashikuar njoftohet se këto dokumente ose njoftime janë shfaqur në faqen web.
- d) Për qëllimet e këtij Neni 20.3, nuk do të merren në konsideratë ditët që nuk janë ditë pune.

## 21. Vulat e Shoqërisë

21.1 Neni 49(1) amendohet, në mënyre që cdo vule e shoqërisë të mund të përdoret nga autoriteti i drejtorëve ose cdo bordi drejtorësh.

21.2 Neni 49(3) amendohet më anë të fshirjes së fjalëve që pasojnë “,” pas fjalës “dokument” dhe zëvendësimit të tyre me “dokumentet duhet të firmosen gjithashtu nga:-

- a) një person i autorizuar në prni të një dëshmitari që vërteton nënshkrimin; ose
- b) dy personave të autorizuar”.

## 22. Trashëgimi i aksioneve

22.1 Neni model 27 modifikohet me shtimin e nje neni të ri 27(4) në termat e mëposhtëm:

“Asnjë nga këto nene nuk e liron pasurine e një ortaku të ndjerë nga asnje detyrim mbi kuotat në zotërim vetjak ose të përbashket të këtij ortaku”.

22.2 Të gjitha Nenet e lidhura me trashëgimin e aksioneve aplikohen ndaj:

- a) cdo njoftimi me shkrim transmetuar Shoqërisë nga marrësi në përputhje me Nenin 28 (1); dhe
- b) cdo mjeti transferte ekzekutuar nga marrësi në përputhje me Nenin 28(2),

Nëse një njoftim ose mjet i tillë janë instrument trasferte të ekzekutuar nga personi nga i cili marrësi fiton të drejtat mbi kuotat, dhe nëse ngjarja prej së cilës lindi e drejta e trashëgimit nuk ka ndodhur.

## 23. Likuidimi

23.1 Në rast se Shoqëria likuidohet, likuiduesi me miratimin e një vendimi të jashtëzakonshëm të Shoqërisë dhe cdo vendimi tjetër të kërkuar nga ligji, mund të ndajë ndërmjet ortakëve në natyrë të gjithë ose një pjesë të aktiveve të Shoqërisë dhe të vlerësojë për këtë qëllim cdo aktiv dhe të vendosë si do kryhet ndarja ndërmejt ortakëve të tjerë ose kategorive të ndryshme të ortakëve. Likuiduesi me miratim të ngjashëm mund të disponojë tërësisht ose pjesërisht aktivët ne truste, por këto truste janë për për përfitim të antarëve sikurse do e vendosë ai, por asnjë ortak nuk do të detyrohet të pranojë ndonjë aktiv për të cilin ekzistojnë detyrime.

## 24. Transferimi i kuotave

24.1

- a) Neni 26(1) amendohet duke shtuar fjalët “dhe, nëse ndonjë nga kuota është zero ose e paguar pjesërisht, marrësi” pas fjalës “dhënësi”.
- b) Drejtorët mund të refuzojnë të regjistrojnë transferimin e ndonjë kuote, dhe, nëse e bëjnë, mjeti i transfertës i duhet kthyer dhënësit bashke me nje njoftim refuzimi që përcakton arsyet e këtij refuzimi sa më shpejt të jetë e mundur dhe në të gjitha kushtet brenda dy muajsh pas datës në të cilën mjeti i transfertës u paraqit për regjistrim, përvec rastit kur drejtorët dyshojnë se transfertea e propozuar mund të jetë mashtrim.

APOSTILE

(Konventa e Hagës 5 Tetor 1961)

1. *Shteti*: Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut

*Ky akt publik*

2. *është firmosur nga*: Gemma Kirsten Hills

3. *agjent në cilësinë e*: Noter Publik

4. *mban vulën/pullën e*: Noterit Publik

VERTETOHET

5. në Londër

6. Më 14 Shkurt 2018

7. *nga* Sekretari i Përgjithshëm i Shtetit të Madhërisë së Saj për Punët e Jashtme

8. *me numër* APO-740622

9. *vula/pulla*

10. Firma

C. Foster  
(firma, vula)

Përktheu  
Jua Josky  
Jybe

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE ELBASAN

Nr. 298 Rep.



Elbasan, me 22.02.2018

### VERTETIM PERKTHIMI

Vërtetohet firma e përkthyeses së gjuhës Angleze Znj. Iva Toska, e njohur personalisht prej meje noteres, e cila deklaroi se përktheu dokumentin bashkangjitur në mënyrë autentike nga gjuha Angleze në gjuhën Shqipe dhe nënshkroi rregullisht sipas ligjit.

**NOTERE**

**ANDUELA ELEZI**